



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.967/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS –Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Princesha Construction” ShPK nga Prishtina të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.S avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Punës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2901/18 të datës 16.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Princesha Construction” ShPK nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr. A.nr.2901/18 të dates 16.11.2021, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2901/18 të datës 16.11.2021, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit “Princesha Construction” ShPK nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar të anulohen si të kundërligjshme, vendimet e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës në Prishtinë, me numër 01 nr.40-133/2018A të datës 03.11.2018 dhe nr.567/2018 të datës 21.12.2018, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kthej shumën prej dhjetë mijë euro (10.000,00) euro të paguara në emër të masës ndëshkimore në bazë të vendimit të atakuar, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi për shkak se nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën aprovuese dhe detyruese në Dispozitivin I të Ndryshohet dhe padia e paditësit të Aprovohet në tërësi si e bazuar ose aktgjykimi ankimor në pjesët e goditura të priset dhe çështja t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut, në Prishtinë, me vendimin përfundimtar nr. protokoli 576/2018 dt.21.12.2018, në procedurën administrative të ankesave, ka refuzuar ankesën e paditësit, dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës 01Nr.40-133/2018A, të datës 03.11.2018, mbi ndalimin e përkohshëm të procesit të punës dhe shqiptimin e gjobës për mos bashkëpunim në shumë 10,000€. Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë duke iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut, në Prishtinë (MTI), respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr.protokoli 576/18 dt.21.12.2018, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa drejtë dhe i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 16.11.2021, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë duke u bazuar në provat siç janë: aktvendimet kontestuese të paditurës, ankesa e paditësit drejtuar të paditurës përmes postës e datës 12.11.2018, kontratën e lidhur në mes të paditësit dhe “Diellona Construction” Sh.P.K, raportet zyrtare të të paditurës si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, andaj duke u bazuar në provat e cekura më lartë gjykata e shkallës së parë, vendosi që ta refuzoj padinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë referohet në nenin 6, 7 dhe 23 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Po ashtu gjykata iu referuar edhe nenit 12 të Udhëzimit Administrativ 07/2012 për Përcaktimin e Gjobjave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës, duke dhënë konstatimin se e paditura drejtë ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, dhe kur ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas

shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e 6, 7 dhe 23 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, po ashtu gjykata iu referuar edhe nenit 12 të Udhëzimit Administrativ 07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar ka dhënë konstatimet faktike lidhur me parregullsitë ligjore të gjetura nga inspektorët e të paditurës, gjatë inspektimit tek paditësi. Në raportin zyrtar të paditurës me nr.01 nr.40-133/2018 të datës 03.11.2018, gjykata vëren se inspektorët e të paditurës gjatë kontrollit inspektues sipas detyrës zyrtare të punishtja në ndërtim të lartë të paditësi, të njëjtit kanë konstatuar se paditësi ka parregullsi nga lëmia e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, ku gjatë inspektimit është konstatuar se në këtë punishte ka rrezikshmëri të lartë, ku objektet ku kanë qenë duke punuar nuk kanë pasur skele, hapësirat e hapura (ashenësorët) kanë qenë të hapura. Pas shikimit në vend të punishtes i ka prituri para zyrës investitori B.G, i cili iu është prezantuar si menaxher i subjektit “princesha Construction” ShPK dhe kanë hyrë në zyrë të paditësit ku pas pesë minutave njëri nga pronarët e paditësit J.M siç iu prezantua ka filluar t’i fyej dhe duke i kërkuar që të largohen nga objekti, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitën e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të sipërcituar. Ndërsa lidhur me pretendimet ankimor të paditësit se nuk është përgjegjës paditësi po duhet të jete përgjegjës pala e trete pune kryesi-Dielloni Construction pasi ata kanë përgjegjësi juridike. Kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e tillë për arsye se, se në asnjë dispozite të kontratës për kryerjen e punëve e cila gjendet në shkresë të lëndës nuk është cekur dhe nuk është bartur përgjegjësia nga siguria dhe shëndeti në punë. Sipas nenit 8 të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë nr. 04./L-161 parashihet se *Punëdhënësi në cilësinë e investitorit, do të lidhë marrëveshje kontraktuale në formë të shkruar, me personat të cilët kryejnë veprimtari pune për të, përkatësisht me kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, në të cilën marrëveshje përcaktohet përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë. 5. Nëse nuk arrihet marrëveshje kontraktuale në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas këtij ligji, bie mbi investitorin.* Për më tutje, duke shtuar këtu faktin se gjatë inspektimit të objektit në fjalë nga inspektorët njëri nga pronarët e paditësit është prezantuar si J.M i cili edhe është nënshkruar i kontratës për ndërtim në cilësinë e personi të autorizuarës Princesha Construction shpk–paditësi.

Sa i përket pretendimeve ankimore se janë bërë shkelje të dispozitave Konfliktit Administrativ dhe dispozitave të ligjit për Procedurën Kontestimore neni 182, pasi gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës nuk i ka zbatuar drejt dispozitat e ligjit, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në provat e lëndës dhe në dispozitat ligjore në fuqi, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimin është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimin. Në arsyetim të aktgjykimin po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimin janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për

provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjithashtu Kolegji, konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejt ligjin kur ka nxjerr konstatimin se paditësi ka rënë ndesh me dispozitat ligjore nga neni 6, 7 dhe 23 parag 4 dhe 5 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë si dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve, prandaj Kolegji nuk i pranoi tani pretendimet e paditësit se e paditura vendimet e goditura i ka nxjerr në kundërshtim me dispozitën e nenit 4 dhe 16 të Ligjit 03/L-181, si dhe nenin 12 të Udhëzimit Administrativ 07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës, ku janë gjetur parregullsi nga lëmia e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe inspektorëve nuk iu është lejuar qasje në inspektim në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ të sipërcituar. Paditësi para gjykatës së shkallës së parë, me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e tij që gjejnë mbështetje faktike apo ligjore, prandaj pretendimet ankimore nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Duke marr parasysh të lartcekurat kolegji i kësaj gjykate në përfundim vlerëson se paditësi nuk ka ofruar argumente relevante me të cilat do të kishte arsyetuar pretendimet e tij se në ndonjë mënyrë ka pasur shkelje e pretenduara në të cilat thirret, përveç se ai është i pakënaqur me rezultatin e procedurës, përkatësisht fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të pretenduara. Kolegji kësaj gjykate konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, rrjedhimisht në këtë kuptim gjykata vlerëson se paditësi nuk ka arritur të mbështes me prova pretendimet e tije në padi ashtu siç parashihet me neni 7 par.1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla,”*. Sipas nenit 319 të LPK-se është paraparë: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta* ndërsa neni 322.2 i po këtij ligji ka paraparë: *Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin*

e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër. Andaj, barra e provës për faktet e pretenduara bien në barrë të paditësit i cili në këtë çështje juridike-administrative nuk ka paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin të kundërtën të asaj që e ka konstatuar e paditura.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar, Kolegji, konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësorë të dispozitave ligjore, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.967/22 datë 25.05.2023

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.